

SKUPŠTINA OPŠTINE TUZI

n/r g-dinu Fadil Kajoshaj – predsjedniku

PREDMET: Dostava Predloga Odluka

NAPOMENA: Uvrstiti u dnevni red naredne sjednice Skupštine Opštine

PODNOŠILAC PREDMETA: Predsjednik Opštine

OBRAĐIVAČ AKTA: Sekretarijat za planiranje, uređenje prostora i komunalne poslove

PRILOG: Predlozi Odluka sa obrazloženjem

Poštovani,

Na osnovu člana 60 stav 2 Statuta opštine Tuzi („Službeni list CG-opštinski propisi“ br. 24/19, 05/20) u prilogu Vam dostavljam:

- Predlog Odluke o postavljanju, građenju i uklanjanju privremenih objekata montažnog karaktera na teritoriji opštine Tuzi i
- Predlog Odluke o donošenju Plana privremenih objekata na tritoriji opštine Tuzi.

Za predstavnika predlagača koji će učestvovati u radu Skupštine i njenih radnih tijela prilikom razmatranja ovog materijala određuje se Ljeka Ivezaj v.d. sekretara Sekretarijata za planiranje, uređenje prostora i komunalne poslove.

KUVENDIT TË KOMUNËS SË TUZIT

Z. Fadil Kajoshaj - Kryetar

LËNDA: Dorëzimi i Propozim Vendimeve

VËREJTJE: Të përfshihen në rendin e ditës në seancën e rrallës së Kuvendit të Komunës

PARASHTRUESI I PROPOZIMIT: Kryetari i Komunës

PËRPUNUESI I AKTIT: Sekretariati për planifikim, rregullim hapësinor dhe punë komunale

SHTOJCË: Propozimi i vendimeve me arsyetime

I nderuar,

Në bazë të nenit 60 paragrafit 2 të Statutit të komunës së Tuzit (“Fleta zyrtare e MZ- dispozitat e komunës” nr. 24/19, 05/20) bashkëngjitur Ju dorëzoj:

- Propozim Vendimin për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme të karakterit montues në territorin e komunës së Tuzit dhe
- Propozim Vendimin për miratimin e Planit të objekteve të përkohshme në territorin e komunës së Tuzit.

Për përfaqësues të propozuesit i cili do të marrë pjesë në punën e Kuvendit dhe trupave punues të tij gjatë shqyrtimit të këtij materiali, përcaktohet Leka Ivezaj, u.d. së sekretarit të Sekretariatit për planifikim, rregullim hapësinor dhe punë komunale.

S poštovanjem,
Me respekt,

PREDSJEDNIK – KRYETARI,

Nik Gjeloshaj


DRAFT

Në bazë të nenit 116, paragrafi 3 i Ligjit për planifikimin hapësinor dhe ndërtimin e objekteve ("Fleta zyrtare e Malit të Zi", nr. 64/17, 44/18, 63/18 dhe 11/19) dhe nenit 53, paragrafi 1, pika 4 të Statutit të Komunës së Tuzit ("Fleta zyrtare e Malit të Zi – dispozitat komunale", nr. 24/19 dhe 05/20), me pëlqimin paraprak të Ministrisë së zhvillimit të qëndrueshëm dhe turizmit dhe Drejtorisë për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, Kuvëndi i komunës së Tuzit, në seancën e mbajtur më _____, 2020 ka sjellë:

VENDIM

për miratimin e Programit për objekte të përkohshme në territorin e komunës së Tuzit

Neni 1

Miratohet Programi i objekteve të përkohshme për territorin e komunës së Tuzit për periudhën nga maji 2020 deri në maj 2025 (në tekstin e mëtejme: Programi i objekteve të përkohshme).

Programi nga paragrafi 1 i këtij neni është pjesë përbërëse i këtij vendimi.

Neni 2

Programi i objekteve të përkohshme përcakton vendndodhjet dhe kushtet për instalimin, gjegjësisht ndërtimin e të gjitha llojeve të objekteve të përkohshme në tokë publike dhe private, të cilat gjenden në territorin e komunës së Tuzit.

Neni 3

Programi i objekteve të përkohshme miratohet për periudhë 5 vjeçare.

Neni 4

Programi i objekteve të përkohshme përbëhet nga pjesa tekstuale dhe grafike. Pjesa tekstuale përmban dispozita të përgjithshme, zonimin hapësinor, analizën e situatës, kategoritë e ndërtesave të përkohshme me kushte urbanistike, si dhe udhëzime për mbrojtjen e natyrës, mjedisit dhe pasurive kulturore. Pjesa grafike tregon vendndodhjet e ndërtesave të përkohshme sipas zonave dhe përmbledhjen tabelare të ndërtesave sipas zonave.

Neni 5

Sekretariati për planifikimin hapësinor dhe punët komunale do të kujdeset për zbatimin e Programit.

Mbikëqyrja e inspektimit mbi zbatimin e Programit të objekteve të përkohshme kryhet nga organi kompetent inspektues.

Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Fleta zyrtare e Malit të Zi – dispozitat komunale".

Numër: 02-030/20-
Tuz, _____, 2020

KUVENDI I KOMUNËS SË TUZIT
KRYETARI,
Fadil Kajoshaj